

Vendim nr. 172, datë 28.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 28.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (H) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **HAJRI THAÇAJ**

OBJEKTI: **Saktësimi dhe plotësimi i vendimit nr. 79, datë 12.12.2025 të Gjykatës Kushtetuese.**

Riçelja e seancës plenare.

Shfuqizimi i vendimit nr. 2, datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 13 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”, në pjesën që parashikon: “Ushtaraku i shërbimit aktiv të përhershëm në Forcat e Armatosura, pavarësisht nga koha e daljes në rezervë/lirim, deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, fiton të drejtën e pensionit të parakohshëm, kur: a) për vjetërsinë në shërbim, femrat 12 vjet, meshkujt 15 vjet; b)

kanë mbushur moshën, femrat 42 vjeç, meshkujt 47 vjeç”, të pakësohet togfjalëshi “për periudhën 01.05.2009 – 04.03.2013” dhe në vend të saj të shtohet togfjalëshi “për periudhën 01.05.2009 deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie”, e përcaktuar në nenin 13 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”.

Rillogaritja e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi të kërkuarit Hajri Thaça për periudhën 01.05.2009 deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie, sipas skemës: “a) 50% të pagës referuese mbi të cilën janë derdhur kontributet; b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit për përcaktimin e mësipërm, masa e pensionit të shtohet me 2% të pagës referuese”.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 38, 44, 47, 48, 50, pika 4, dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuarisi ka qenë me detyrë “oficer” me gradën “Nënkolonel” deri në nxjerrjen në rezervë me urdhrin nr. 355, datë 23.07.2003. Pas përfitimit të pagesës kalimtare në masën 23.479

lekë, kërkuesi i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH, Tiranë*) për përfitimin e pensionit të parakohshëm. Duke mos qenë dakord me masën e pensionit të parakohshëm, ai i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e të paditurës të paguajë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996. Në përfundim të proceseve gjyqësore, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit kundër vendimit të gjykatës së apelit që kishte rrëzuar padinë e tij. Në këto kushte, në datën 20.03.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar vendimet nr. 1040 (86-2023-1381), datë 11.12.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-4497, datë 22.10.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe vendimin unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 (*vendimi unifikues nr. 3/2016*) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.

2. Me vendimin nr. 79, datë 12.12.2025 (*vendimi nr. 79/2025*), Gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Gjykata ka arsyetuar se Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhet t'u kthente përgjigje pretendimeve të kërkuesit për ligjin e zbatueshëm dhe kriteret e përcaktimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Ajo gjykatë nuk mund të mjaftojë me një arsyetim të kufizuar, por duhet të mbante qëndrim dhe të arsyetonte si për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe në veçanti nëse kufizimi “jo më shumë se masa e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi” i parashikuar në ligjin nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” përfshinte edhe periudhën kohore 01.05.2009-01.07.2009. Ndërsa për sa i përket periudhës pas datës 01.07.2009, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 10142/2009*), deri në datën 04.03.2013, Gjykata ka vlerësuar se arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk duket i paarsyeshëm dhe që të bjerë ndesh me jurisprudencën e Gjykatës, pra që e bën gjykimin të padrejtë.

3. Në datën 12.03.2026 (*sipas shënimit të shërbimit postar*) kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 79/2025, si dhe riçeljen e seancës plenare. Në datën 22.04.2026 kërkuesi ka paraqitur një kërkesë të dytë për shtimin e

objektit, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit nr. 2, datë 18.02.2013 të Gjykatës (*vendimi nr. 2/2013*), si i papajtueshëm me Kushtetutën, ndryshimin e disa dispozitave ligjore dhe rillogaritjen e pensionit të tij.

II

Pretendimet e kërkuessit

4. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar si vijon:

4.1. *Në paragrafin 15 të vendimit* Gjykata ka arsyetuar se kërkuessi nuk ka qenë palë në procesin ku është dhënë vendimi unifikues, për rrjedhojë nuk legjitimohet *ratione personae* në aspektin procedural. Ky paragraf duhet të saktësohet, pasi, ndonëse kërkuessi nuk ka qenë palë në atë proces, një kriter i tillë nuk përmendet në Kushtetutë dhe në Ligjin Organik të Gjykatës, të cilët kërkojnë vetëm justifikimin e interesit të kërkuessit për t'iu drejtuar Gjykatës. Vendimi unifikues prek të gjithë ushtarakët, pra edhe kërkuessin, për rrjedhojë ai ka interes për të kundërshtuar këtë vendim, pasi cenohet drejtpërdrejt në të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese.

Po në këtë paragraf, Gjykata ka vlerësuar të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues për atë sa gjykatat e zakonshme i janë referuar atij për të interpretuar dhe për të zbatuar ligjin në çështjen konkrete. Gjykata nuk mund ta kushtëzojë analizën e vendimit unifikues me referimin në arsyetimin e gjykatave të zakonshme, pasi këto të fundit qëllimisht nuk i kanë analizuar ligjet e zbatueshme në mosmarrëveshjen në fjalë. Gjykata duhet ta shpallë antikushtetues vendimin unifikues nr. 3/2016, si dhe vendimet e gjykatave të zakonshme që kanë zbatuar këtë vendim antikushtetues.

4.2. *Në paragrafin 16 të vendimit* Gjykata ka paraqitur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në teori, por nuk ka specifikuar nëse kërkuessi pretendimet e tij i ka ngritur më parë në gjykatat e zakonshme. Kërkuessi e ka përmbushur këtë kriter për të gjitha pretendimet e tij si për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara me ligj dhe me vendime gjyqësore, ndarjes dhe balancimit të pushteteve, cenimit pa ligj të së drejtës së pensionit, ndalimit të fuqisë prapavepruese, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë përpara ligjit, parimit të hierarkisë së normave etj.

Gjykata duhet të saktësojë se kërkuksi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për të gjitha pretendimet e tij.

- 4.3. Në paragrafët 17, 18, 19 dhe 23 të vendimit Gjykata ka vlerësuar se njoftimi i kërkuksit është bërë në mënyrë të rregullt nëpërmjet shpalljes publike dhe, për rrjedhojë, për pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme në gjykatën e apelit ai nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Gjykata duhet të saktësojë se, ndonëse është bërë njoftimi me shpallje, kërkuksi nuk është njoftuar personalisht pavarësisht se kishte lënë të dhënat e kontaktit. Në këto kushte, vetëm njoftimi me shpallje e bën atë të pavlefshëm. Gjykata duhet të saktësojë se pretendimi i tij është i bazuar.
- 4.4. Në paragrafin 21 të vendimit Gjykata ka vlerësuar se, për sa u përket pretendimeve për cenimin e parimit të disponibilitetit dhe të subsidiaritetit nga Gjykata e Lartë, si dhe të parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve nga vendimi unifikues, kërkuksi i ka paraqitur për herë të parë në parashtrimet përpara seancës së datës 22.07.2025, për rrjedhojë ato nuk mund të merren në shqyrtim, sepse janë paraqitur nga kërkuksi pasi ishte vendosur kalimi i çështjes në seancë plenare. Gjykata duhet të saktësojë se në rastin e kërkuksit zbatohet Rregullorja për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, e cila parashikon se palëve pjesëmarrëse në gjykim u kërkohet të paraqesin parashtrimet me shkrim brenda një afati 30-ditor. Kërkuksi ka zbatuar të gjitha komunikimet me shkrim midis tij dhe Gjykatës.
- 4.5. Vendimi nr. 2/2013 i Gjykatës është i papajtueshëm me Kushtetutën, për rrjedhojë duhet të shfuqizohet. Interesi publik i analizuar në këtë vendim nuk ekziston, pasi kërkuksit i është ulur pensioni në masën 50%. Vendimi unifikues ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi njësimi dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore nuk janë kompetencë e Kolegjeve të Bashkuara, pasi kompetencat e Gjykatës së Lartë janë reformuar. Ai vendim është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon asnjë pasojë juridike. Gjykata duhet të rillogarisë pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi të kërkuksit për periudhën 01.05.2009 deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie në masën 50% të pagës referuese dhe për çdo vit tjetër vjetërsie të shërbimit masa të shtohet me 2% të pagës referuese. Interpretimi i ligjit

nr. 10142/2009 është në juridiksionin e Gjykatës, pasi shoqërohet me shkeljen e të drejtave dhe lirive kushtetuese të kërkuarit. Gjykata duhet të pakësojë togfjalëshin “për periudhën 01.05.2009-04.03.2013” në nenin 13 të ligjit nr. 10142/2009, duke e zëvendësuar me atë “për periudhën 01.05.2009, deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie”.

- 4.6. Gjykata duhet të vendosë riçeljen e seancës plenare për shkak të këtyre pasaktësive në përputhje me nenin 44 të Ligjit Organik të saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

5. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

6. Në kuptim të parashikimeve të dispozitave të lartpërmendura, Kolegji evidenton se një prej rasteve në të cilin mund të vihet në lëvizje Gjykata për të shqyrtuar vendimmarrjet e saj, është kur kërkohet, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit, saktësimi dhe plotësimi i vendimit, me qëllim ndreqjen e gabimeve në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar, por pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes (*neni 80 i Ligjit Organik të Gjykatës*). Ky parashikim është detajuar edhe në nenin 43 të Rregullores, i cili përcakton se vendimi i Kolegjit, i Mbledhjes së Gjyqtarëve ose i Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohet, por veçse mund të saktësohet, plotësohet ose ndreqen gabime në shkrim, ose ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në to.

7. Kolegji vëren se në rastin konkret kërkuari i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për saktësimin e vendimit nr. 79/2025 të Gjykatës. Lidhur me kriteret paraprake të kësaj kërkesë, referuar nenit 80 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe Rregullores, kërkuari legjitimohet *ratione personae*, duke qenë se është palë ndërgjyqëse e vendimmarrjes së mëparshme të Gjykatës që kërkohet të saktësohet. Gjithashtu, Kolegji konstaton se vendimi nr. 79/2025 i është njoftuar

kërkuesit në datën 13.01.2026, ndërsa kërkesa për saktësimin e këtij vendimi është paraqitur në datën 12.03.2026, pra brenda afatit ligjor 2-mujor, prandaj ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

8. Për sa i takon përmbajtjes së pretendimeve të ngritura në kërkesë, Kolegji vëren se për pretendimin në pikën 4.1. kërkuesi ka parashtruar se legjitimohet *ratione personae* edhe për vendimin unifikues të kundërshtuar në ankimin kushtetues individual, pasi ai vendim prek të gjithë ushtarakët përfshirë edhe kërkuesin. Ai ka pretenduar gjithashtu se Gjykata nuk mund ta kushtëzojë analizën e këtij vendimi me referim në arsyetimin e gjykatave të zakonshme, por duhet ta deklaronte atë si të papajtueshëm me Kushtetutën.

9. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vëren se në vendimin nr. 79/2025 Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae* për kundërshtimin e tij në aspektin procedural. Megjithatë, në aspektin substancial, Gjykata ka çmuar ta analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues për aq sa referuar atij gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin në çështjen konkrete. Për sa u takon vendimeve unifikuese Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se kërkuesit nuk legjitimohen për kundërshtimin e tyre për sa kohë nuk kanë qenë palë në proces (*shih vendimet nr. 24, datë 23.04.2025; nr. 72, datë 17.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Qëllimi i Gjykatës nuk është të vërë në diskutim vlerën që kanë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë në rendin juridik dhe as detyrimin ligjor që kanë gjykatat më të ulëta që të marrin parasysht dhe të zbatojnë në çështje analoge zgjidhjet e dhëna në këto vendime (*shih vendimet nr. 26 datë 22.05.2015; nr. 6 datë 17.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se nuk konstatohen gabime në shkrim ose pasaktësi të dukshme në vendim në kuptim të nenit 80 të Ligjit Organik të Gjykatës, por ky pretendim i kërkuesit lidhet në thelb me mënyrën e arsyetimit të Gjykatës për sa i përket legjitimitetit *ratione personae* të tij, çka nuk mund të merret në shqyrtim përsëri nga Gjykata.

10. Në lidhje me pretendimin e parashtruar në pikën 4.2., Kolegji vëren se kërkuesi ka argumentuar se Gjykata nuk ka specifikuar nëse ai i ka ngritur më parë pretendimet e tij në gjykatat e zakonshme. Po kështu, ai ka pretenduar se Gjykata duhet të saktësojë se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për të gjitha pretendimet e tij. Për sa i përket këtij pretendimi, Kolegji evidenton se paragrafi 16 i vendimit nr. 79/2025 përmban kriterin kushtetues të shterimit të mjeteve juridike. Lidhur me këtë kriter, Gjykata në atë vendim ka vlerësuar se vetëm për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, kërkuesi nuk ka

shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata ka vlerësuar se ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Në këto kushte, nuk vërehet ndonjë pasaktësi e dukshme në kuptim të nenit 80 të Ligjit Organik të Gjykatës. Edhe në këtë rast pretendimi i kërkuarit lidhet me mënyrën e vendimmarrjes së Gjykatës, çka nuk mund të merret në shqyrtim.

11. Për sa i takon pretendimit në pikën 4.3., Kolegji konstaton që kërkuari ka pretenduar se njoftimi i seancës në gjykatën e apelit nuk është bërë në mënyrë të rregullt, pasi ai nuk është njoftuar individualisht. Gjykata në vendimin nr. 79/2025 ka vlerësuar se bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes, të paktën 15 ditë përpara. Ndërkohë, rregullat procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë, pikërisht neni 482, paragrafi i tretë, i Kodit të Procedurës Civile (KPC), parashikojnë se njoftimi i palëve nga sekretaria gjyqësore bëhet përmes shpalljes së listave të shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për gjykimin kushtetues të kërkesës së kërkuarit, Gjykata ka evidentuar se gjykata e apelit ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore për sa i përket njoftimit të palëve dhe se për sa kohë ai nuk ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit të gjykatës së apelit, nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim.

12. Për sa më lart, Kolegji vëren se pretendimi i kërkuarit nuk lidhet me ndonjë gabim ose pasaktësi të dukshme të vendimit në kuptim të nenit 80 të Ligjit Organik të Gjykatës, por me mënyrën sesi Gjykata e ka vlerësuar këtë pretendim. Në kushtet kur vendimmarrja e Gjykatës nuk mund të vihet në diskutim ose të bëhet objekt kontrolli as prej vetë asaj, pasi përbën gjë të gjykuar (*res judicata*), Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

13. Në lidhje me pretendimin në pikën 4.4., kërkuari ka pretenduar se në vendimin nr. 79/2025 nuk janë marrë në shqyrtim parashtrimet e tij me shkrim të depozituara prej tij përpara seancës plenare. Kolegji vëren se në atë vendim Gjykata ka vlerësuar se këto pretendime përbëjnë shtesë të shkaqeve të ankimit kushtetues individual. Referuar nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të

Gjykatës dhe nenit 185 të KPC-së, shkaqet e ankimit kushtetues individual mund të ndryshohen (shtohen ose pakësohen) deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Sikurse Gjykata ka referuar edhe në jurisprudencën e saj, pretendimet e parashtruara nga kërkuesit, pasi është vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, nuk mund të merren në shqyrtim (*shih vendimet nr. 76, datë 02.12.2025; nr. 28, datë 11.04.2024; nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë shkak, Kolegji vlerëson se vendimi nr. 79/2025 nuk përmban pasaktësi në këtë drejtim, prandaj edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Për më tepër, Kolegji vëren se në thelb pretendimet e kërkuesit kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit nga gjykatat e zakonshme të ligjeve në fushën e ish-ushtarakëve dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, të cilat janë marrë në shqyrtim nga Gjykata në drejtim të së drejtës për gjykim të drejtë, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, të lidhur me parimin e sigurisë juridike. Gjykata në përfundim të analizës së saj ka vlerësuar se kërkesa e kërkuesit duhet të pranohet pjesërisht, për rrjedhojë pretendimet e tij në këtë drejtim nuk përbëjnë gabime ose pasaktësi në kuptim të nenit 80 të Ligjit Organik të Gjykatës.

15. Në përfundim, në analizë të pretendimeve të kërkuesit për saktësimin e vendimit nr. 79/2025 të Gjykatës, Kolegji vëren se procesi kushtetues i shqyrtimit të ankimit kushtetues individual të kërkuesit ka përfunduar me vendimin përfundimtar të Gjykatës që ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Nuk rezulton që ndonjë gjykatë ndërkombëtare të ketë konstatuar cenimin e të drejtave themelore të tyre nga procesi kushtetues i përfunduar me vendimin nr. 79/2025. Ndonëse kërkesa është paraqitur në kuptim të nenit 80 të Ligjit Organik të Gjykatës, në thelb kërkuesi kundërshton qëndrimin e mbajtur prej saj dhe mënyrën e trajtimit të disa pretendimeve të tij në vendimin në fjalë. Pavarësisht mënyrës së pasqyrimin të argumenteve të ngritura në kërkesë, ritheksohet se vendimet e Gjykatës nuk mund të vihen në diskutim ose të bëhen objekt kontrolli as prej vetë asaj, pasi përbëjnë gjë të gjykuar (*res judicata*). Po kështu, Kolegji vlerëson se Gjykata nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018; nr. 84, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të këtij parimi kushtetues, pretendimet e kërkuesit janë marrë parasysh nga Gjykata, e cila u ka kthyer përgjigje duke vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës.

16. Po kështu, Kolegji vëren se kërkuesi ka paraqitur edhe shtesë objekti, duke pretenduar në thelb shfuqizimin e vendimit nr. 2/2013 të Gjykatës, ndryshimin e një dispozite ligjore të ligjit nr. 10142/2009 dhe rillogaritjen e pensionit të tij. Për sa i përket kërimit të parë, konstatohet se Kushtetuta, në nenet 124, 132 dhe 145, pika 2, të saj, shprehet qartësisht për forcën detyruese dhe natyrën përfundimtare të vendimeve të Gjykatës. Po kështu, nenet 72, pika 7, dhe 76, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës parashikojnë se vendimet e kësaj Gjykate kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim, pra edhe për vetë Gjykatën. Në këtë këndvështrim, jo vetëm kërkuesi nuk legjitimohet për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimit nr. 2/2013 të Gjykatës, por edhe vetë ajo nuk mund të vërë më në diskutim vendimet e saj, përveç rastit kur një gjykatë ndërkombëtare ka konstatuar cenimin e të drejtave themelore të kërkuesve prej tyre.

17. Për sa i përket kërimit tjetër për ndryshimin e dispozitës ligjore, konkretisht nenit 13 të ligjit nr. 10142/2009, Kolegji konstaton se kërkuesi në thelb nuk ka kërkuar shfuqizimin e tij, por zëvendësimin e togfjalëshit “01.05.2009-04.03.2013” me atë “01.05.2009-deri në plotësimin e moshës për pension të plotë pleqërie”. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar funksionin e saj si ligjvënës negativ për garantimin e kushtetutshmërisë, e cila, në respektim të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në kompetencat e ligjbërësit për të normuar rregullimin e drejtë të dispozitave ligjore (*shih vendimet nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, ky kërkim nuk hyn në juridiksionin kushtetues në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës. Po kështu, Kolegji vlerëson se edhe kërkitimi tjetër për rillogaritjen e pensionit të kërkuesit nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë këto kërtime nuk mund të merren në shqyrtim.

18. Për sa më sipër, kërkuesi nuk gjendet në ndonjë prej rasteve të parashikuara nga nenet 71/c dhe 80 të Ligjit Organik të Gjykatës, si dhe neni 43 i Rregullores, ndaj kërkesa për saktësimin e vendimit nuk mund të pranohet.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31, 31/a, pika 2, shkronja “e”, dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.